


Marrëveshjet për detyrimin për ushqim për fëmijët

Bini dakord me kushtet e urdhrit lidhur me detyrimin për ushqim për fëmijët para se t'i drejtoheni Gjykatës për Çështjet Familjare

Marrëveshja për detyrimin për ushqim për fëmijët ju lejon:

- Të merrni një urdhër zyrtar gjykate **duke u paraqitur më rrallë në Gjykatën për Çështjet Familjare**, në shumicën e rasteve.
- **Të diskutoni dhe të kuptoni** përlogaritjet për përcaktimin e shumës që duhet paguar me urdhër gjykate.
- **Të bëni pyetje dhe të merrni përgjigje** në lidhje me detyrimin për ushqim për fëmijët, nga përfaqësues shumë të përgatitur të Shërbimit të Klientit për Detyrimin për Ushqim për Fëmijët.
- **Të përcaktoni dhe të negocioni kushtet e marrëveshjes** pa praninë e prindit tjetër, nëse kjo është më e përshtatshme për familjen.

Procesi me katër hapa



Pse nuk duhet t'i drejtoheni menjëherë gjykatës?

Ne si Zyrë e Shërbimeve të Detyrimit për Ushqim për Fëmijët, e kuptojmë se marrja e urdhrit lidhur me detyrimin për ushqim për fëmijët është i vështirë. OCSS-ja dëshiron të ofrojë një mjedis të qetë dhe mbështetës për prindërit. Kur të dy prindërit bien dakord, rezultatet janë më të mira për të gjithë, veçanërisht për fëmijët. Për më shumë informacion në lidhje me detyrimin për ushqim për fëmijët, vizitoni adresën nyc.gov/hra/ocss.

Hapat e radhës

Zbuloni nëse marrëveshja është zgjidhja më e përshtatshme për ju. Na dërgoni email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us ku të përfshini emrin tuaj të plotë dhe ID-në e çështjes lidhur me detyrimin për ushqim për fëmijët ose datën e lindjes nëse keni një çështje aktuale të hapur të detyrimit për ushqim për fëmijët. Gjithashtu, përfshini kohën më të përshtatshme se kur mund t'ju kontaktojmë.

Për mënyrat tona të tjera të kontaktit, shihni <https://on.nyc.gov/contactocss>.